



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 130

Prishtinë, më 12.11.2013, ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Boban Todorović.

Mungoi : Daut Haradinaj, Nijazi Idrizi, Liburn Aliu .

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 8.10.2013,
3. Shqyrtimi i Projektligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje,
4. Konfirmimi për leximin e dytë për Projektligjin për fshatin Zymi i Hasit,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 8.10.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 8.10.2013 me vërejtjet e përfshira nga **Sevdije Lama** dhe **Afërdita Berisha-Shaqiri**.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje

Anëtarët e Komisionit dhe bashkëpunëtorët që janë të angazhuar në këtë Projektligj, përfunduan shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje duke hartuar vërejtjet tabelare të cilat në formë të amendamenteve do të votohen në mbledhjen e radhës së Komisionit pas përmirësimeve eventuale nga stafi i komisionit.

4. Konfirmimi për leximin e dytë për Projektligjin për fshatin Zymi i Hasit

Kryetari Nait Hasani kërkoi nga antarët e Komisionit konfirmimin për lexim të dytë në seancë për Projektligjin për fshatin Zymi i Hasit pasi që në Komisionet e Përhershme ka përfunduar shqyrtimi i Projektligjit në fjalë. Komisioni nuk kishte vërejtje në lidhje me këtë konfirmim dhe Projektligji për fshatin Zymi i Hasit u votua me shumicë të votave.

5. Te ndryshme

Në këtë pikë u diskutua nevoja e vazhdimit të punës së grupit punues rreth hartimit të **PROJEKTLIGJIN MBI VEPRIMTARITË E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJËSJELLËSIT, UJËRAVE TË NDOTURA DHE TË FURNIZUESËVE TË UJIT ME SHUMICË** ndaj në javën tjetër pritet vazhdimi i grupit punues.

Mbledhja përfundoi në orën 16,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani